



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Nr. 2293 / Prot.

Patos, më 13 / 07 / 2026

NJOFTIM


Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkisë Patos nr. 54, datë 04.11.2021 “Për miratimin e rekomandimeve të nxjerra nga Akt-Ekspertiza e Institutit të Ndërtimit nr. 1419/3 prot., datë 18.10.2021 “Për objektin e shkollës dhe kopshtit Grizë, i cili e konsideron me rrezikshmëri të lartë për përdorim”, VKB nr. 64, datë 26.11.2021 “Për miratimin e procedurës për marrjen me qira të një objekti për kopsht fëmijësh në fshatin Grizë-Lënginas”, VKB nr. 82, datë 17.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026” bashkia Patos ndodhur në kushtet kur nuk ka akoma një vendimmarrje për rikonstruksionin e shkollës dhe kopshtit Grizë-Lënginas, shpall procedurën me objekt **“Marrje ndërtese me qira për kopsht fëmijësh në fshatin Grizë-Lënginas”**.

Kriteret e objektit:

1. Ndërtesa duhet të ketë kushte optimale infrastrukturore.
2. Dokument pronësie, kontratë me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe furnizim me ujë.
3. Vendndodhja e ndërtesës të ketë një distancë jo shumë të largët nga qendra e fshatit.

Të interesuarit të paraqesin dokumentacionin e kërkuar pranë bashkisë Patos, brenda datës 31.07.2026, ora 16:00.

Ky njoftim duhet të publikohet në stendat e afishimit publik të bashkisë Patos dhe në faqen zyrtare të institucionit.


KRYETAR
Faton Duro